

Tiranë, më 01/08/2024

Shtetesi: Ilir Dushkaj

Blerësi: Salsano Rapi

KONTRATË SHITJE KUOTE

Baza Ligjore

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- Ligji Nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues"

NENI 1

QËLLIMI I KONTRATËS

1.1 Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë të 1 (një) kuote e cila përfaqëson 63% të kapitalit të shoqërisë nga

Shtetesi Z. Ilir Dushkaj tek blerësi Z. Salsano Rapi.

1.2 Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim.

1.3 Në përcaktim të kushteve, palët konsiderojnë të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin përsipër të ekzekutojnë veprimet e tyre brenda kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.


NENI 2

OBJEKTI I KONTRATËS

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate, shtetesi Z. Ilir Dushkaj i shet në favor të blerësit Z. Salsano Rapi kuotën e tij në masën 63 % që ai zotëron në shoqëri, në total 1 (një) kuotë, që përfaqëson 63% (gjashtëdhjetë e tre përqind) të kapitalit të shoqërisë me emimin të përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

NENI 3

1 Faqe



ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGIMIT

3.1 Çmimi i shitjes së kuotës që zotëron ortakut Z. Ilir Dushkaj, i cili përfaqëson 63% (gjashtëdhjetë e tre përqind) të kapitalit është përcaktuar ndërmjet palëve të jetë në vlerën, 630 (gjashtëqind e tridhjetë) lekë.

3.2 Po ashtu, të dyja palët deklarojnë se shuma prej, 630 (gjashtëqind e tridhjetë) lekë, është shlyer tërësisht shitesit nga ana e blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njëri-tjetrit.

NENI 4

PËRGJEGJËSITË DHE GARANCI TË PALËVE

4.1. Pala shitëse nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se kuota objekt shitje është plotësisht e lirë nga cdo barrë, detyrime apo pengesa të tjera
- b) se miratimi për transferimin e kësaj kuote në drejtim të palës blerëse është marrë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe organet e shoqërisë,
- c) shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate, ai heq dorë nga të gjitha të drejtat që i ka takuar në cilësinë e ortakut të shoqërisë, apo cdo të drejtë tjetër pa kufizim.
- d) shitësi garanton blerësin se cdo garanci/deklaratë e mëposhtme është e vërtetë dhe e saktë në cdo aspekt, në të kundert do të mbaj përgjegjësi ligjore ndaj blerësit: -shoqëria nuk ka shoqëri të tjera në të cilat ka direkt ose indirekt pjesëmarrje në kapitalin e saj brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, -i ka dhënë cdo informacion të nevojshëm në lidhje me pretendime të palëve të treta

4.2. Shitësi është i detyruar të paguajnë të gjitha taksat e aplikueshme në përputhje me ligjet në fuqi, lidhur me transferimin e kësaj kuote sipas kësaj kontrate shitje.

NENI 5

EFEKTET E KONTRATËS

- 5.1. Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 5.2. Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 6

INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Palët detyrohen të mbajnë të fshehtë të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrdhënies së tyre në përputhje me këtë kontratë.

NENI 7

TRANSFERIMI I TE DREJTAVE

7.1. Menjëherë pas nënshkrimit, palët kanë rënë dakort që kjo kontratë do të regjistrohet në regjistrin tregtar, dhe blerësi i ri merr përsipër kryerjen e të gjitha procedurave pranë QKB për të bërë të mundur transferimin e kuotës në emër të tij.

7.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi Z.Illir Dushkaj zhvishet tërësisht nga pronësia mbi kuotën që ai zotëron në shoqëri si dhe nga cdo e drejtë tjetër mbi këto kuota. Zotëruesi i kësaj kuote bëhet blerësi i ri Z.Salsano Rapi, i cili bëhet pronar dhe zotëruesi i 1 (një) kuote në vlerën prej 630 (gjashtëqind e tridhjetë) lekë që përfaqëson 63% (gjashtëdhjetë e tre përqind) të kapitalit në shoqërinë "SHEGISA" sh.p.k.

NENI 8

INTERPRETIMI I KONTRATËS

8.1. Nëse do të jetë e nevojshme të bëhet interpretimi i kësaj kontrate, do të synohet të përcaktohet se kush ka qënë qellimi real dhe i përbashkët i të dyja palëve, pa u mbështetur në kuptimin literal të fjalëve, dhe gjithashtu duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, përpara dhe pas përfundimit të kësaj kontrate.

8.2. Kushtet e kësaj kontrate do të interpretohen njëra pas tjetrës, duke dhënë secila kuptimin që rrjedh nga tërësia e kontratës në fjalë. Kontrata do të interpretohet në konfidencë nga palët.

NENI 9

LIGJI I APLIKUESHËM DHE GJYKATA KOMPETENTE

9.1 Kontrata është hartuar dhe interpretuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet tregtare në fuqi.

9.2 Blerësi dhe shitësi angazhohen të bejnë cdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet apo konfliktet e krijuara midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociimeve të drejtëpërdrejta.

9.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, ato do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.

NENI 10

ANEKSE TË KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumenta që do të quhen

Aneksë të Kontratës;

Vendimi i Asamblesë së Ortakëve i shoqërisë "SHEGISA" shpk datë bashkëlidhur

Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqëritë


Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u redaktua në tre (tre) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, nga të cilat, nga një kopje e mbajnë palët, një kopje depozitohet në QKB, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë.

Shitësi:

Ilir Dushkaj



Blerësi:

Salsano Rapi

